

<i>Emri i Fondit</i>	Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur SIGAL
<i>Struktura Ligjore</i>	Fond Pensioni* Licencuar nga AMF me licencë nr. 2, datë 30.03.2011
<i>Administrimi i Fondit</i>	SIGAL UNIQA INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Sh.a.
<i>Themeluar</i>	Janar 2006
<i>Monedha</i>	Lekë
<i>Banka Depozitare</i>	Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.
<i>Auditues</i>	Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k.

*Rregulluar nga Ligji nr. 76/2023, "Për fondet e pensionit Privat"

<i>Komision në Hyrje</i>	0%
<i>Komision në Dalje</i>	0%
<i>Komision Vjetor Administrimi</i>	1.50%
<i>Penalitet për tërheqje të parakohshme</i>	Sipas Rregullores së AMF
<i>Komision Performance</i>	0%
<i>Shuma fillestare e kuotës</i>	1.000 Lekë
<i>Kontributi fillestar minimal</i>	1.000 Lekë
<i>Kontributi minimal pasues</i>	1.000 Lekë

Objektivat dhe Politika e Investimit

Objektivat e Investimit

Fondi i Pensionit ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në banka të nivelit të dytë të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Të dhënat kryesore për Fondin në 31 Tetor 2024

<i>Vlera Neto e Aseteve</i>	3,076,827,029.23 Lekë
<i>Numri i anëtarëve</i>	14,841
<i>Çmimi i Kuotës</i>	1,709.3883 Lekë
<i>*Fitimi vjetor (31/10/23-31/10/2024)</i>	4.00 %

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

** Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.




Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.

Për Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL, treguesi është në nivelin 1, ose nivelin më të ulët të rrezikut.

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portofoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Treguesi është i bazuar në të dhënat historike të 5 viteve të fundit dhe kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

Performanca e Fondit

Performanca e Fondit deri në 31.10.2024

Gjatë muajit Tetor 2024 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës. Norma e rritjes të çmimit të kuotës për 10 mujorin 2024 ka rezultuar 3.38%.

Fitimi vjetor neto (%) për 12 muajt e fundit (Periudha: 31/10/23-31/10/24) ka shënuar nivelin 4.00%.



Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.

Performanca vjetore (%)

	2019	2020	2021	2022	2023
Fondi	3.43	3.26	3.37	3.29	3.52


Rritja e Vlerës Neto të Aseteve (%)

	2020-2021	2021- 2022	2022- 2023
Fondi	28.37	21.68	11.88



*** Të dhënat e mësipërme janë të ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbëjnë garanci për të ardhmen.

Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një rritje e rendimentit për titujt për të cilët janë organizuar ankande gjatë këtij muaji. Raporti mesatar i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.35, një rritje nga 1.17 raport mbulimi gjatë muajit shtator 2024.

Obligacioni 2 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.85 % nga 3.88% me një rënie prej 0.03 % krahasuar me ankandin e muajit Shtator 2024.

Obligacioni referencë 3 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.13 % nga 4.12 % me një rritje prej 0.01% krahasuar me ankandin e muajit Shtator 2024.

Obligacioni referencë 5 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.73 % nga 4.79 % me një rënie prej 0.06% krahasuar me ankandin e muajit Shtator 2024.

Obligacioni 7 vjeçar ka rezultuar me rendiment 5.36 % duke ruajtur të njëjtën normë me ankandin zhvilluar në muajit shtator 2024.

Obligacioni 10 vjeçar ka rezultuar me rendiment 5.93 % nga 6.13 % me një rënie prej 0.20% krahasuar me ankandin e muajit Korrik 2024.

Për obligacionet me afat 15 vjeçar nuk është zhvilluar ankand në muajin Tetor 2024, ndaj i referohemi interesave të emetimeve të fundit respektivisht 6.98% në Gusht 2024.

Informacion Praktik

Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 156, 157 dhe 158 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Vullnetar". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondin e Pensionit Vullnetar SIGAL. Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondit të Pensionit Vullnetar SIGAL dhe në <https://fondisigal.com.al/>

Kontakt:

Rr. "Ukraina e Lirë", Tiranë

Email: info@fondisigal.com.al

Tel: +355 (0) 44 511 666